



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

1753
Nr. ___ Prot

Tiranë më, 18 11 2025

VENDIM

Nr. 74, datë 18. 11 2025

Për ngritjen dhe funksionimin e Podcast-it të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Bazuar në Ligjin nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përkatësisht në nenin 4, pikat 2, 7, 8 dhe 12; në Statutin e Akademisë së Shkencave, nenet 67 dhe 68 që parashikojnë botimet, materialet promovuese e popullarizuese dhe aktivitetet e komunikimit publik; në mbështetje të objektivave të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për rritjen e pranisë publike, forcimin e promovimit dhe komunikimit shkencor si dhe zhvillimin e marrëdhënieve me publikun, në mbledhjen e saj të datës __. __ 2025, Kryesia e Akademisë së Shkencave,

VENDOSI:

1. Në funksion të fuqizimit të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun, nën drejtimin dhe përgjegjësinë e tij, të ngrëjë Podcast-in e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (“Podcast-i i ASHSH”), si një instrument modern komunikimi dhe promovimi të veprimtarisë shkencore dhe botuese të ASHSH-së.
2. Podcast-i të instalohet në një hapësirë të dedikuar brenda ambienteve të ASHSH, që është fondi i bibliotekës, dhe të pajiset me infrastrukturën e nevojshme për regjistrim profesional audio-video, duke garantuar cilësi të lartë teknike dhe standard të unifikuar institucional.
3. Podcast-i prezantohet me logon e ASHSH-së dhe shpërndahet në faqen zyrtare, në kanalin zyrtar në YouTube dhe në rrjetet sociale zyrtare të ASHSH.
4. Kancelari i Akademisë së Shkencave ngarkohet të përshtasë dhe të sigurojë ambientet e dedikuara dhe pajisjet e nevojshme teknike për podcast-in, si dhe të garantojë funksionalitetin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e tyre, brenda datës 30 dhjetor 2025.
5. Përgjegjësi i Sektorit të marrëdhënieve me jashtë dhe publikun ngarkohet të hartojë e propozojë strukturën dhe përbërjen e podcast, si dhe rregulloren e funksionimit të tij; të përcaktojë objektivat dhe detyrat e stafit që merr pjesë në realizimin e podcast-it, brenda një afati një javor.

Ky vendim në fuqi menjëherë.


KRYETARI
Akad. Skënder GJINUSHI